



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT TË GJYKATAVE DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
DREJTORIA E ORGANIZIMIT TË GJYKATAVE DHE STANDARDEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

Lënda: Kthim përgjigje

**ZNJ. D.T
ISP**

TIRANË

E nderuar znj. {...},

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar kërkesa juaj, protokolluar me nr. 1264 Prot., datë 23.03.2021, ku kërkonti informacion në lidhje me masat e marra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për Kolegjin Zgjedhor, në kushtet e pandemisë Covid -19.

Në kërkesën tuaj për informacion ju parashtroni pyetjet si vijon:

- “ 1.A ka përcaktuar KLGJ mjedise pune dhe masa mbështetëse administrative për Kolegjin Zgjedhor? (situata e pandemisë, kufizimet).
2.A ka vendosur KLGJ pika kontakti të Kolegjit Zgjedhor ku mund të adresohen qytetarët, subjektet, OJF-të dhe media?
3.A ka parashikuar KLGJ publikimin e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor, dhe nëse po, në cilën adresë?
4.A ka të dhëna KLGJ nëse të gjithë anëtarët e Kolegjit Zgjedhor do të jenë në punë gjatë periudhës zgjedhore e postzgjedhore? (arsye shëndeti, leje, pamundësi fizike, lëvizja, banimi etjt)?”*

Në lidhje me pyetjen e parë, mbi mjediset e punës dhe masat mbështetëse administrative për Kolegjin Zgjedhor, neni 146, pika 7 e Kodit Zgjedhor, të ndryshuar parashikon se:

“Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vë në dispozicion të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor mjedise të mjaftueshme pune, pajisje dhe personel, në mënyrë që të sigurojë kryerjen në kohë dhe në mënyrë profesionale të detyrave të veta. Vendimet e Kolegjit botohen në faqen e internetit të Gjykatës Administrative të Apelit.”

Për zbatim të nenit 146 të Kodit Zgjedhor, Kolegji Zgjedhor pajiset me mjedise pune dhe mbështetje administrative nga Gjykata Administrative e Apelit. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me kërkesë të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, me Vendimin nr. 99, datë 18.03.2021 *“Për caktimin e vendit të zhvillimit të seancave gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”* ka caktuar vetëm vendin e zhvillimit të seancave gjyqësore.

Vendimi i i KLGJ-së nr. 99, datë 18.03.2021, parashikon zhvillimin e seancave gjyqësore në ambjentet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim respektimin e masave për zhvillimin e seancave gjyqësore, gjatë pandemisë Covid-19. Salla e vënë në dispozicion të Kolegjit Zgjedhor, vlerësohet se plotëson kushtet e sigurisë dhe solemnitetin e seancës gjyqësore; sikurse mundëson distancimin social dhe masat higjeno-sanitare.

Sa i përket pyetjes suaj të dytë dhe të tretë, mbi pikat e kontaktit dhe publikimin e vendimeve gjyqësore, parashikimet ligjore kanë përcaktuar në mënyrë taksative publikimin e tyre në faqen e internetit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Mbi pyetjen tuaj të fundit,sa i përket pjesëmarrjes në seanca të antërave të Kolegjit Zgjedhor, Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi kompetent për administrimin dhe mbikëqyrjen e sistemit gjyqësor. Ai ka kompetenca të përcaktuara në ligj. Për zbatim të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën përzgjedhjen e anëtarëve të Kolegjit dhe plotëson vakancat e krijuara në Kolegj gjatë mandatit të tyre.

Sjellim në vëmendje se, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ushtron veprimtarinë e tij brenda kornizave ligjore, duke respektuar pavarësinë e gjykatave. Për zbatim të nenit 149, të Kodit Zgjedhor, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të vendosë lehtësimin e ngarkesës së punës së antarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor:

“Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi merr edhe mendimin e kryetarit të gjykatës, ku gjyqtari ushtron funksionin, vendos lehtësimin e ngarkesës së punës së tij.”

Ndërsa lejet vjetore, dhe mungesat për arsye shëndetësore nuk bëjnë pjesë në kompetencat ligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi do të cënonin parimin e pavarësisë dhe vetëadministrimit të gjykatave.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,